

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika Boom® P

SHKUMË PUR E ZGJERUESHME PËR FIKSIME, MBUSHJE DHE IZOLIME

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika Boom® P është shkumë poliuretani me 1 përbërës dhe me tharje të shpejtë, e krijuar për aplikim të lehtë me majë plastike.

PËRDORIMET

Sika Boom® P është krijuar për fiksime, izolim dhe mbushje të fugave të lidhjes përreth kasave të dritareve dhe dritareve, hyrjeve të tubacioneve dhe pajisjeve elektrike. Sika Boom® P ofron izolim kundër zhurmës, të ftohtit dhe rrjedhjeve pas një aplikimi të vetëm.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- 1 përbërës
- Aplikim i lehtë
- Shkallë e lartë zgjerimi
- Tharje e shpejtë
- Izolim termik shumë i mirë
- Amortizim efikas i tingujve
- Pa HFC

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan
Ambalazhi	kanaçe 750 ml, 12 copë/ kuti, 1008 copë/ paletë
Ngjyra	E verdhë e lehtë
Jetëgjatësia	Sika Boom® P ka jetëgjatësi prej 15 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar nëse plotësohen kushtet e magazinimit. Ambalazhet e hapura të Sika Boom® P duhet të përdoren brenda 4 javësh.
Kushtet e magazinimit	Sika Boom® P duhet të ruhet në pozicion vertikal, në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.
Dendësia	0,022 ± 3 kg/dm ³

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	0,03 MPa
Qëndrueshmëria e përmasave	± 10%.
Rezistenca ndaj zjarrit	B3
Rezistenca termike	~ 0,036 W/mK.
Përthithja e ujit	Max. 1% vëllim

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Max. ~ 45 dm ³
Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.
Lagështia relative e ajrit	30 % min. / 95 % max.
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.
Koha e maturimit	Sika Boom® P thahet plotësisht pas 12 orësh
Koha e prerjes	~ 30 minuta
Koha e tharjes së sipërfaqes	5 deri në 10 minuta

UDHËZIME APLIKIMI

Për aplikimin e Sika Boom® P vlejnjë të gjitha rregullat e pranuar të ndërtimit.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vaj, graso, pluhur dhe material të lirë të shpërbërë. Boja, korja e çimentos (qumështi) dhe ndotësit e tjerë duhet të hiqen. Sika Boom® P ngjitet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Lagni praraprakisht nënshtresën me ujë të pastër, pasi kjo gjë siguron se shkuma thahet plotësisht dhe parandalon zgjerimin dytësor të shumës.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Tundni mirë Sika Boom® P min. 20 sekonda përpara përdorimit. Përsërisni pas ndërprerjeve të gjata të përdorimit. Mbërtheni majën pa shtypur valvulën. Sasia e nxjerrë mund të rregullohet duke ushtruar më shumë ose më pak presion tek butoni. Mbushini fugat e thella në disa shtresa. Kujdesuni që secila shtresë të thahet dhe të zgjerohet mjaftueshëm duke spërkatur me ujë midis secilës shtresë ose duke lënë kohë të mjaftueshme pritjeje. Mos i mbushni plotësisht pjesët e zbrazëta, pasi shkuma zgjerohet gjatë tharjes. Të gjitha elementet e ndërtimit duhet të fiksohen përkohësisht derisa shkuma të thahet plotësisht.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni menjëherë të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me Sika Boom®-Cleaner dhe/ose Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i mbetur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Fleta e të dhënave të sigurisë

KUFIZIME

- Temperatura minimale e aplikimit duhet të jetë +10°C.
- Për të patur shumë me cilësi të mirë, temperatura e kanaçes nuk duhet të ndryshojë më tepër se 10°C nga temperatura e ambientit.
- Mbroni kanaçen nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe temperaturat mbi +50 °C (rrezik shpërthimi).
- Nevojitet lagështi për tharjen e duhur të shumës.
- Aplikimi i lagështisë së pamjaftueshme mund të çojë në zgjerim të mëvonshëm dhe të paqëllimshëm të shumës.
- Mos i mbushni plotësisht pjesët e zbrazëta, pasi shkuma zgjerohet gjatë tharjes.
- Të mos përdoret mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon), silikon, vaj, graso apo disarmentë të tjerë.
- Sika Boom® P nuk ka rezistencë nga dritës UV.
- Lexoni të gjitha rekomandimet teknike dhe të sigurisë të cilat janë të printuara mbi ambalazhin e Sika Boom® P.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika Boom® P
Maj 2019, Botimi 01.01
02051406000000032

SikaBoomP-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf